


Nr 7493 prot

27.12.2019



REPUBLIKA E SHQIPERISË
PREFEKTI QARKU FIER

Nr. 1961 Prot.

Lënda: Kthim përgjigje për ligjshmërinë e vendimeve të Këshillit Bashkiak Roskovec.

Drejtuar: Znj. Majlinda BUFI
KRYETARE E BASHKISË ROSKOVEC

Për dijëni: Z. Kadri HYSKA
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK ROSKOVEC

Fier, më 27.12.2019
30.12.2019
Këshilli Bashkiak Roskovec

ROSKOVEC

Në përgjigje të shkresës Tuaj me Nr. 7492 prot. datë 24.12.2019, protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier me Nr. 1961 prot. Datë 27.12.2019, bazuar në Ligjin Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" neni 16, shqyrtoam vendimet e Këshillit të Bashkisë Roskovec të miratuara në datën 20.12.2019 si dhe dokumentacionin plotësues për vendimet si më poshtë:

Vendimi Nr. 109 datë 20.12.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec "Mbi miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Roskovec" Është në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 49 pika 1 dhe 2 si dhe neni 54 shkronja "j".

Vendimi Nr. 110 datë 20.12.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec "Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për periudhën 1-30 nëntor 2019" Eshtë në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" nenet 9, 24; Ligjin Nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" neni 21; VKM-në Nr. 597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" Kreu IV pika 2 si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.5 datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6%" (i ndryshuar).

Vendimi Nr. 111 datë 20.12.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec "Për miratimin e Bursave të shtetit për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet Arsimore Publike për vitin



shkollor 2019-2020” Është në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” si dhe në zbatim të VKM-së Nr.666 datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në Institucionet Arsimore Publike”.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Baki BALA

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

Sekretar i Përgjithshëm

Arben VELO

